



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1731, datë 20.12.2011**

**Për**

**“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.12.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 120, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e AMC sh.a., me nr. 4963/1 prot. datë 1.11.2011, (AKEP: nr. 1690 prot., datë 1.11.2011) “*Ankim administrativ kundër operatorit alternativ Nisatel sh.p.k. për ofrimin e dy tarifave të ndryshme terminimi në rrjetin e tij si dhe moslidhjen e interkoneksionit për AMC FIX duke tejkaluar afatet e parashikuara në Ligj*”);
- Shkresa e AKEP nr. 500/1 prot, datë 4.4.2011 drejtuar AMC sh.a “Dërgohet konfirmimi i njoftimit”;
- Shkresa e AKEP nr. 500/4 prot, datë 10.5.2011 drejtuar AMC sh.a “Njoftim për përdorimin e numeracionit” (Bashkëlidhur konfirmimi i njoftimit sipas rregjimit të autorizimit të përgjithshëm datë 4.4.2011);
- Shkresa e AMC sh.a., me nr. 1401/13 prot., datë 1.7.2011, drejtuar Nisatel sh.p.k. “Mbi kërkesën e AMC për implementimin e numeracionit fiks dhe nënshkrimin e adendumit në kontratën kryesore të interkoneksionit për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse nga AMC sh.a”;
- Shkresa e Nisatel sh.p.k., me nr. 6911 prot., datë 19.7.2011, drejtuar AMC sh.a “Kthim përgjigje”;;
- Shkresa e AMC sh.a, me nr. 4963 prot., datë 6.10.2011, drejtuar Nisatel sh.p.k “Lidhur me draft amendamentin e telefonisë fikse” (bashkëlidhur drafti për telefoninë fikse Amendamenti nr. 1 i MI datë 31.03.2011 i lidhur midis AMC sh.a dhe Nisatel sh.p.k);
- Korespondenca me e-mailet midis sipërmarrësve;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe, duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

AMC sh.a., me shkresën nr. 4963/1 prot, datë 1.11.2011, (AKEP: nr. 1690 prot, datë 1.11.2011) “Ankim administrativ kundër operatorit alternativ Nisatel sh.p.k. për ofrimin e dy tarifave të ndryshme terminimi në rrjetin e tij si dhe moslidhjen e interkoneksionit për AMC FIX duke tejkeluar afatet e parashikuara në ligj”, sqaron si më poshtë:

1. AMC ka njoftuar me anë të e-mail të gjithë operatorët si dhe Nisatel për fillimin e një shërbimi të ri nga ana e saj më datë 2.6.2011;
2. AMC sh.a ka dërguar shkresën me nr. 1401/13 prot datë 1.7.2011 “Mbi kërkesën e AMC për implementimin e numeracionit fiks”. Me anë të kësaj shkrese AMC lajmërohet për një tarifë terminimi në rrjetin e saj fiks prej 1.5 lekë siç e kishte ofruar te të gjithë operatorët e tjerë alternativë. Operatorët e tjerë alternativë në të njëjtën kohë kanë tarifë terminimi 1.5 lek për AMC e cila është e njëjtë si për trafikun e origjinuar nga rrejt mobile i AMC ashtu edhe për atë që do të origjinohet nga rrjeti fiks i saj. AMC thekson se në këtë proces përjashtim bën vetëm Abcom i cili e tarifon AMC si për mobile ashtu edhe për fiks me 2.5 lek/min për terminimin në rrjetin fiks të AMC.
3. Nisatel sh.p.k më datë 19.7.2011 dërgon përgjigje në të cilën kërkon një tarifë terminimi 3.7 lek/min për trafikun e origjinuar nga rrjeti fiks i AMC, ndërkoh që në kontratën kryesore të interkoneksionit midis AMC dhe Nisatel tarifa e terminimit për trafikun e origjinuar nga rrjeti mobil AMC është 1.5 lek/min.
4. AMC më datë 17.8.2011 me anë të një e-mail, i ka kthyer përgjigje shoqërisë Nisatel, duke argumentuar qe Nisatel nuk mund të paraqiste një tarifë terminimi prej 3.7 lek/min për trafikun e origjinuar nga fiks AMC e cila është e ndryshme nga tarifa e terminimit për trafikun e origjinuar nga rrjeti mobile.
5. AMC sh.a thekson se, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, i cili është i njëjtë për të gjithë operatorët që operojnë në Republikën e Shqipërisë nuk ka diskriminim sa i përket origjinimit të trafikut për tarifën e terminimit. Nese tarifa për terminimin në rrjetet e lëvizshme është 1.5 lek/min, ajo duhet të jetë e njëjtë edhe për terminimin për trafik të origjinuar nga rrjeti fiks i AMC. Nisatel edhe pse është komunikuar disa herë për parimin e mosdiskriminimit, nuk heq dorë nga pretendimi i saj.
6. AMC për çështjen e tarifave dhe kapaciteteve mban qëndrimin si më poshtë:  
Në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin Nisatel, bazuar në kuadrin rregullator nuk duhet të ketë dhe nuk ka dallim sipas origjinës së thirrjes për tarifën e terminimit.
  - AMC vlerëson se trafiku i interkoneksionit nga/drejt numeracionit fiks të AMC të kalojë përmes trunkut të trafikut kombëtar ekzistues. Duke qënë se është një produkt i ri, akoma i palancuar në treg, përse i takon kapaciteteve momentalisht nuk e konsideron të nevojshme.
  - Në lidhje me garancinë financiare, bazuar në marrëveshjen ekzistuese midis palëve me nr. 1553 prot, datë 31.03.2011, në çdo rast të tejkalimit të trafikut me me shume se 30% për 2 muaj të njëpasnjëshëm apo të rrietjes së kapaciteteve ekzistuese mund të bëhet rishikim i garancisë.
7. AMC nga gjithë komunikimet me Nisatel konstaton se:

Nisatel ka tejkaluar të gjitha afatet për të interkonektuar numeracionin fiks të AMC me rrejtin e tij fiks, afat ky i përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu detyrimet që burojnë nga kuadri rregullator duhet të jene të njëjta për të gjithë operatorët që operojnë në treg në zbatim të neneve 7, 8, 15, 39, 47, 49, 51 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, tarifa e terminimit e ofruar nga Nisatel për AMC fiks duhet të jetë e njëjtë për terminimin e trafikut të AMC mobile.

8. Për sa më sipër AMC i kërkon AKEP që në kuadër të këtij procedimi administrativ të urdhërojë lidhjen e interkoneksionit dhe nënshkrimin e marrëveshjes sipas kërkit të AMC, duke detyruar Nisatel që të ofrojë të njëjtën tarifë terminimi për trafikun e terminimit në rjetin e tij, pavarësisht se nga është origjinuar trafiku nga rrjeti mobile apo rrjeti fiks i AMC sh.a.
9. Duke qënë se, sipërmarrësit AMC sh.a dhe Nisatel sh.p.k megjithë negociatat, dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për nënshkrimin e amendamentit Nr.1 të marrëveshjes së interkoneksionit midis tyre, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

### **V E N D O S:**

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
  - Altin RRAPAJ Kryetar
  - Jonida GJIKA Anëtar
  - Donald SHTREPI Anëtar
  - Florida ÇELA Anëtar
  - Ded JAKAJ Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k, për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;

5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**